

EC

MA NDRYSHE
ORGANIZTA JO-QEVERITARE
EMANCIPIMI CIVIL

E DREJTA MBI QYTETIN

PROJEKTI "RIKTHIMI I QYTETIT - E DREJTA MBI QYTETIN PËR
GRUPET E NËNPËRFAQESUARA TË KOMUNITETIT NË PRZREN"
"E DREJTA E TË RINJËVE DHE FËMIJËVE MBI QYTETIN"



PRIZREN 2017



E DREJTA MBI QYTETIN

PROJEKTI "RIKTHIMI I QYTETIT - E DREJTA MBI QYTETIN PËR GRUPET E NËNPËRFAQËSUARA TË KOMUNITETIT NË PRIZREN"
"E DREJTA E TË RINJËVE DHE FËMIJËVE MBI QYTETIN"

Ky raport është pregaditur në kuadër të projektit "RIKTHIMI I QYTETIT - E Drejta mbi Qytetin për grupet e nënpërfaqësuar të komunitetit në Prizren", i përkrahur financiarisht nga National Endowment for Democracy. Ky raport është pregaditur në kuadër të projektit "RIKTHIMI I QYTETIT - E Drejta mbi Qytetin për grupet e nënpërfaqësuar të komunitetit në Prizren", i përkrahur financiarisht nga National Endowment for Democracy.



**National Endowment
for Democracy**
Supporting freedom around the world

Ky manual është produkt i dalur nga një proces gjithëpërfshirës me të rinjtë dhe fëmijët, të cilin EC Ma Ndryshe e organizon për të përkrahur të drejtën e tyre për përfaqësim si një nga grupet më të ndërpërfaqësuar të Prizrenit. Punësoria "E drejta e të rinjve dhe fëmijëve mbi qytetin (nga perspektiva e të drejtave të të rinjve)" është bazë e këtij dokumenti, por qëllimi i tij përtej raportimit të të gjeturave të punëtorisë është të shërbej si manual dhe udhërrëfyes për të gjithë ne. Si fëmijë, si të rinjë, si të rritur dhe si vendimmarrës, të krijojmë qytete ku zëri i të rinjve dhe fëmijëve dëgjohej dhe idetë e tyre merren parasysh.


Autor: Zana Sokoli, Arkitekte
Bashkëpunëtor: Fjollë Godanca, Arkitekte
PRIZREN, Dhjetor 2017

EDREJTA MBI PRIZRENIN



Unë kam të drejtë të jem
pjesë e planifikimit për të
ardhmen e qytetit tonë.

MANUAL mbi të drejtat e të rinjve dhe fëmijëve mbi qytetin



Kush duhet të ketë të drejtë mbi qytetin?

Cka është e drejta mbi qytetin dhe kujt i takon ajo? Pse komuniteti duhet të përfshihet në proces të planifikimit dhe të ketë rol aktiv mbi të ardhmen e qytetit?

01. E drejta mbi qytetin!

Hyrje



Unë kam të drejtë të
jetoj dhe të jem unë!
Ne të gjithë jemi unik!

E drejta mbi qytetin nuk është vetëm e drejtë për ta banuar qytetin. Është e drejtë elementare për të formësuar mjedisin tonë jetësor sipas nevojave dhe dëshirës sonë.

David Harvey

Gjatë dekadës së fundit, e drejta mbi qytetin është bërë njëri ndër konceptet më të përfolura në studimet urbane. Platforma të ndryshme rreth së drejtës mbi qytetin sot përbëjnë pjesën më të rëndësishme të agjendave në qarqet e politikave urbane, në akademi dhe në mesin e aktivistëve. Përkundër faktit që e drejta mbi qytetin avokohet dhe konceptohet në forma të ndryshme nga akterët e mësipërm, ka disa vlera që pothuajse të gjitha versionet e së drejtës mbi qytetin i përqafojnë. Të gjithë flasin për 'përdoruesin e hapësirës urbane' që në përditshmërinë e tij të banimit në qytet ka edhe të drejtë mbi të. Këtu edhe vihet theks i vecantë tek vlera e përdorimit të hapësirës urbane si të tillë, përtej vlerës së saj të shkëmbimit. 'Kontratë e qytetarisë' e quante Lefebvre, njëri ndër avokuesit e parë të së drejtës mbi qytetin. Ai e shihte të drejtën mbi qytet gjithmonë si rezultat i politikave lokale, si manifestim dhe frut i pretendimeve kolektive të bëra nga qytetarët e mobilizuar, të cilët përveç së drejtës, bartin me vete edhe përgjegjësinë ndaj qytetit.

Çka adreson planifikimi?



REKOMANDIMI 1

Promovimi i pjesëmarrjes aktive të fëmijëve: Informimi dhe përfshirja e të rinjve dhe marrja parasysh e pikëpamjeve të tyre si qenie njerëzore individuale, të cilët gëzojnë të drejtën e barabartë si qytetarë aktiv. Pjesëmarrja e të rinjve në procese të planifikimit është qenësore pasi që i bën ata 'partner' të qeverisë lokale. Perspektiva unike që ata kanë duhet të merret parasysh në vendimet mbi qytetin.



E KALUARA

E kaluara ndërton të ardhmen tonë. Ne duhet të mësojmë nga gabimet e bëra dhe t'i shfrytëzojmë ato si mësim për të ndërtuar të nesërmen.

E SOTMJA

E sotmja është e rëndësishme për ne sepse nevojat tona si të rinjë, adoleshentë dhe si studentë ndryshojnë nga të tjerët. E sotmja jonë duhet të merret parasysh!

E ARDHMJA

E ardhmja që planifikojmë sot do të jetë e sotmja e dikujt nesër! Gjithashtu ne si të rinjë në të ardhmen do të gëzojmë statusin e të punësuarit, njeriut familjar, etj. Planifikimi i së ardhmes do të na e bëjë jetën më të mirë neve dhe gjeneratave të ardhshme.

Sa dëgjohe zëri i të rinjve në nivelin lokal?

Dokumentet e planifikimit, kornizat ligjore, strategjitë, praktikat e komunës në zbatimin e gjithëpërfshirjes.

02. E drejta e të rinjve dhe fëmijëve mbi qytetin



"Një qytet miqësor për fëmijët është një qytet, apo çfarëdo sistemi lokal i qeverisjes, i përkushtuar në përbushjen e të drejtave të fëmijëve. Është qytet ku zërat, nevojat, prioritetet dhe të drejtat e fëmijëve janë pjesë integrale e politikave publike, programeve dhe vendimeve. Është, si rezultat, një qytet i përshtatshëm për të gjithë".

Korniza për Qytetet e Fëmijëve në Veprim

Përfshirja dhe fuqizimi i rinisë është i rëndësishëm në shumë aspekte. Është në radhë të parë hap drejt përbushjes së parimit për gjithëpërfshirje, duke e bërë pjesë të vendimmarrjes njërën ndër grupet më të ndërpërfaqësuara në komunë. Tutje, të rinjtë dalëngadalë ndërtojnë vetëkënaqësi kur e dijnë që kanë pasur ndikim në çështjet që janë qenësore në përmirësimin e kualitetit të jetës së komunitetit të tyre.

Sa më të pasura do të ishin planet zhvillimore të qytetit po të merrej parasysh se si të rinjtë e përjetojnë procesin e rritjes në një lagje urbane/rurale, sa janë këto lagje miqësore për ta; apo se si fëmijët e formësojnë qytetin e së ardhmes, në çfarë mase procesi i urbanizimit e ka ndikuar të menduarit e tyre.

Vazhdimi i neglizhimit dhe mos degjimit të zërit të tyre do të ketë pasoja në të ardhmen. Të rinjtë duke u injoruar dhe stereotipizuar do të fillojnë të krijojnë barriera rreth vetes duke shfaqur probleme me vetëvlerësim, duke pasur ngecje në punë grupore, dhe duke e bartur ndjenjën e pafuqisë me vete edhe kur të jenë bërë të rritur vendimmarës.



Rinia është potenciali më i madh që Prizreni ka, është e ardhmja të cilën e proklamojnë dokumentet e planifikimit. Kjo duhet të konsiderohet aset kryesor i qytetit i cili duhet ta orientoj zhvillimin e tij të qendrueshëm në ekonomi të dijes. Zëri i të rinjve dhe fëmijëve vazhdon të mos dëgjohej, e kjo më së miri shihet në anketimet dhe punëtoritë me ta. Shumica as që kanë pasur rast të shohin ndonjëherë se cka përmban një dokument i planifikimit, e aq më të tepër të dijnë se çfarë të drejta kanë ata mbi qytetin.



REKOMANDIMI 2

Korniza ligjore 'miqësore' për të rinjtë: e cila siguron që legjislacioni, kornizat ligjore dhe platformat qeverisëse vazhdimisht i promovojnë dhe mbrojnë të drejtat e të gjithë të rinjëve.

Nëse refrohemi tek legjislatura kosovare, në ligjin Nr. 04/L-174 për planifikim hapësor në Kosovë, parimet si promovimi i interesave të përbashkëta të qytetarëve të Kosovës, promovimi i procesit demokratik të pjesëmarrjes publike dhe përfshirjes ndërsektoriale, apo sigurimi i qasjes publike në të gjitha dokumentet e planifikimit hapësor, i gjejmë të përcaktuara në nenin 4 të këtij ligji. Inkurajimi dhe sigurimi i pjesëmarrjes publike në procesin e hartimit dhe të zbatimit të dokumenteve të planifikimit hapësor; njoftimi dhe shqyrtimi publik i planeve para se ato të finalizohen, i përcakton neni 11 i këtij ligji. Anketimet e realizuara nga EC-i në Prizren që përfshijnë të gjitha grupacionet e mundshme të popullsisë shfaqin përqindje të ultë të zbatimit të udhëzimeve administrative, duke qenë se përqindje të larta të të anketuarve deklarojnë të mos kenë qenë pjesëmarrës në këto procese. Aq më tepër rinia.

Problemet e identifikuara nga të rinjtë dhe fëmijët e Prizrenit në anketat vjetore të EC Ma Ndryshe. Të listuara në tabelë janë paraqitur 8 problemet që vazhdojnë të përsëriten cdo vit në anketim.

01. 

Ndriçimi në hapësirat publike

Mungesa e ndriçimit në hapësira publike, në rrugë të banimit si dhe në objektet shkollore është njëri ndër faktorët kyç që cenon sigurinë e të rinjve.

02. 

Bllokimi i trotuareve

Të parandalohet parkimi i veturave pranë objekteve shkollore dhe përgjatë trotuareve të qytetit.

03. 

Mungesë e gjelbërimit dhe hapësirave për lojë në hapësirat publike

Hapësira të pamjaftueshme publike dhe të gjelbërta. Keqmenaxhim i atyre ekzistuese. Secila lagje në Prizren duhet të ketë zonën e saj të gjelbër dhe publike të përcjellur me hapësira për lojë.

04. 

Keq-menaxhimi i hapësirave publike (konsumimi i substancave narkotike).

Disa nga hapësirat publike në qytet janë bërë të paqasshme për të rinjtë për shkak të pranisë së personave që konsumojnë lëndë të ndryshme narkotike.

05. 

Barrierat fizike për PAK

Të instalohen pjerrinat, sidomos në shkolla dhe objekte publike me qëllim që të mundësohet qasje e lire e personave me aftësi të kufizuara.

06. 

Gjendja në shkolla dhe në hapësirat rreth shkollave

Zonat përreth shkollave dhe mjediseve ku frekuenton rinia: ndriçimit publik dhe edhe rrugët duhet të ofrojnë një siguri më të madhe.

07. 



Mungesa e infrastrukturës rekreative - sportive

Buxhet i mirëfilltë për rregullimi në infrastrukturës sportive në qytet me fokus të veçantë në Stadiumin e qytetit dhe Qendrën sportive me qëllim të krijimit të kushteve të mirëfillta në këto objekte; dhe ndërtimi i qendrave të reja.

08. 

Mungesa e infrastrukturës sociale

Komuna të investojë në renovimin e 'Shtëpisë së Kulturës' si dhe të investojë në qendra të reja për të rinjtë duke ndjekur shembullin e Lumbarhit.



Punëtorja "E drejta e të rinjve dhe fëmijëve mbi qytetin"
Projekti "Rikthimi i qytetit- E Drejta mbi Qytetin për grupet e
nënpërfaqësura të komunitetit në Prizren"

03. Të dalurat nga punëtorja



Duke u referuar në problemet e lartëcekura, mosangazhimi i fëmijëve në proces të planifikimit vazhdon të jetë fakt shqetësues në komunën e Prizrenit. Fëmijët deklarohen që të vetmet aktivitete ku ata kanë mundësi nga afër të shohin dhe të kuptojnë rolin e tyre në qytet, janë punëtoritë që organizohen kryesisht nga organizatat joqeveritare. Komuna e Prizrenit thirret nën parimet e gjithëpërfshirjes të cilat i parasheh edhe vetë korniza ligjore, por nuk angazhohet që t'i jetësoj ato në praktikë, e fakt më i mirë për këtë janë deklaratat e vetë fëmijëve.

Është Projekti "Rikthimi i qytetit- E Drejta mbi Qytetin për grupet e nënpërfaqësura të komunitetit në Prizren" një përpjekje për të mbështetur këto grupe për të fituar dhe gëzuar plotësisht të drejtën e tyre mbi qytetin (dhe të drejtat e njeriut) nëpërmjet aktivizmit dhe mobilizimit për të nxitur reformën demokratike të planifikimit urban në Prizren. Brenda këtij projekti gëzojnë hapësirë edhe fëmijët e të rinjtë prizrenas.

Punëtorja e parë në kuadër të projektit është realizuar pikërisht me të rinjtë dhe fëmijët dhe ka pasur për qëllim shqyrtimin e sfidave më të rëndësishme me të cilat ballafaqohen grupet e nënpërfaqësura të qytetit, në këtë rast rininë, dhe vizionimin e tyre sipas metodologjisë së planifikimit urban me pjesëmarrje.

Unë kam të drejtë të rritem
në një qytet të pastër dhe
të shëndetshëm.

Unë kam të drejtë të flas në
emër timin. Mendimet dhe
opinionet e mia janë vetëm të
mijat dhe unë kam të drejtë t'i
shpreh ato.



Marrë parasysh faktin që fjalori i planifikimit është në masë të madhe i panjohur për të rinjtë pjesëmarrës në punëtori, gjuha dhe metodologjia e përvetësuar ka qenë e tillë që t'i bëjë ata të ndjehen të lirë të shprehen dhe të ofrojnë idetë e tyre.

Punëtorja është ndarë në tri faza të ndryshme:

a) Prezantim nga lehtësuesi i punëtorisë për konceptet bazë mbi të drejtën e qytetit për të gjithë;


b) Punë grupore mbi zona të caktuara publike në qytetin e Prizrenit si dhe

c) Punë individuale për vlerësimin e hapësirave të brendshme dhe të jashtme shkollore, aty ku femijët dhe të rinjtë e kalojnë pjesën më të madhe të ditës së tyre.





Të rinjtë dhe fëmijët kanë pasur mundësi që në grup dhe individualisht të shfaqin të gjitha problemet që ata aktualisht i kanë në përditshmërinë e tyre dhe gjithashtu të vizionojnë parqet, hapësirën rreth shkollës së tyre, lumin e qytetit etj; në përpjekje për të dhënë një vizion të përgjithshëm i cili do të gjente zbatim në çfarëdo hapësire të ngjashme në qytet. Qëllimi primar i punëtorisë ka qenë që t'i përfshijë të rinjtë dhe t'i bëjë ata të vetëdijshëm për rolin dhe potencialin e tyre në qytet. Kur ata me të vërtetë ndihen të përfshirë në proces do të arrijnë të zhvillojnë ndjenjën e përkatësisë, shpirtin e tyre demokratik si qytetarë aktivë e që padyshim do t'i bëjë ata të rritur përgjegjës për të mirën e përbashkët.



Lokacionet e përzgjedhura në punën grupore



MULLIRI




KEJI



RRUGA "REMZI ADEMAJ"



PARKU "REMZI ADEMAJ"



PARKU I QYTETIT

Vlerësimi për zonat dhe intervenimet që duhen bërë,
të radhitura në bazë të intervenimeve prioritare sipas të rinjve.



PARKU
"REMZI ADEMAJ"



RRUGA
"REMZI ADEMAJ"



KEJI



MULLIRI



PARKU I
QYTETIT



Hapësira të sukseshme urbane

Ideimi i hapësirave të ndryshme në qytet të prioritizuara nga të rinjtë dhe fëmijët.

04. Prizreni ideal i të rinjve

Hapësira të përzgjedhura në qytet

Zaptimi i trotuateve, trafiku i ngarkuar, mungesa e ndriçimit, papastërtia, siguria, sinjalizimi, mungesa e hapësirave të gjelbra, janë vetëm disa nga problemet që të rinjtë i identifikojnë në qytet, pa marrë parasysh se për cilën lagje a hapësirë bëhet fjalë. Duke qenë se për të marrë ide konkrete nga një grupemoshë e tillë, kontekstualizimi i problemit në hapësirë të caktuar është i domosdoshëm. Prandaj, gjatë punëtorisë janë përvetësuar 5 lokacione të ndryshme në Prizren, në mënyrë që së bashku të vizionohej e ardhmja e këtyre hapësirave nga idetë kreative të të rinjve. Gjithsesi metodologjia e punëtorisë ka qenë e tillë, që edhe pse punohej në një hapësirë të caktuar, vizioni do të ishte më gjithëpërfshirës dhe do të gjente zbatim në cilëndo hapësirë tjetër të ngjashme në qytet. Bie fjala, propozimi për ndriçimin dhe sigurinë në një shkollë, do të vlente edhe për të gjitha shkollat tjera të qytetit.

Pesë hapësirat e zgjedhura për punën grupore (shiko hartën në faqen 24) fillimisht janë vlerësuar nga pjesëmarrësit për gjendjen e tyre aktuale, në mënyrë që identifikimi i problemeve dhe mangësive të tyre të zgjoj të menduarit kreativ tek të rinjtë për të propozuar ndryshimin që duhet bërë.

Vizionimi përfshinë idetë e të rinjve për hapësirat rreth lumit në qendër të qytetit, hapësirat potenciale për piknik dhe rekreim në dalje të qytetit drejt Marashit, lirim të rrugëve të ngarkuara nga trafiku, parkun e qytetit, parqet dhe hapësirat publike rreth shkollave të tyre.

Në vijim ilustrohen pesë rastet e vizionuara nga të rinjtë, nën emërtimin 'Prizreni ideal i të rinjëve'.











Dashuria për qytetin

Sa e duan të rinjtë Prizrenin? A i plotëson qyteti kushtet që ata të jetojnë të përmbushur? Sa ndihen ata të gatshëm të bëhen pjesë e ndryshimeve?

05. Sa e duam Prizrenin?






REKOMANDIMI 3

Ndërgjegjësim i përbashkët mbi të drejtat e të rinjve: Të vlerësojmë dhe të bëhemi të vetëdijshëm për të drejtat e tyre në kontekstin lokal. Kjo i lejon të rinjtë të lidhen me qytetin, të krijojnë pronësi dhe të jenë të përgjegjshëm për të. Qytetin në të cilin ata përjetojnë çdo ditë rritjen e tyre.

Nuk është mister pse disa qytete na pëlqejnë më shumë se të tjerat. Kur pyet dikë se sa i pëlqen qyteti ku jeton, shumë arsye fshihen pas PO-së ose JO-së së tyre. Se si ndihemi, sa jemi të lumtur me punën që bëjmë, sa kohë shpenzojmë për të arritur çdo ditë në vend të punës apo shkollës, ndikohen direkt nga qyteti ku jetojmë dhe kualiteti i jetës që ai ofron. Ka disa principe që i bëjnë disa qytete të dallojnë nga të tjerët e që na bëjnë neve t'i duam më shumë se të tjerat. Vlerësojeni vet Prizrenin brenda këtyre principeve:

1. Jo shumë kaotike por as jo shumë brenda 'rregullit': Rregulli është i domosdoshëm në qytet, por kur është i tepruar bëhet i mërzitshëm. Në anën tjetër shumica e qyteteve janë rrëmujë e vërtetë, që i bëjnë të duken sikur askush nuk është nën përkujdesje të tyre. Prandaj qytetet duhet të synojnë kompleksitet të organizuar, që do të thotë rregull por edhe shumëllojshmëri;
2. Qytete të gjalla, që shfaqin jetë: Rrugë të mbushura me njerëz, mobiliar urban i dizajnuar jo vetëm për funksionalitet por edhe që të duken bukur, biznese që promovojnë kulturën lokale, vende për ngrënie tipike për qytetin dhe zonën përreth, hapësira publike për të gjitha grupmoshat etj;
3. Qytete kompakte: me shumë sheshe dhe hapësira publike që janë ftuese për të gjitha kategoritë e banorëve të qytetit, pa marrë parasysh statusin e tyre social;
4. Qytete me karakter të theksuar lokal: Çdo shoqëri ka nevojë të ndryshme, stile të ndryshme të jetesës qoftë individuale qoftë kolektive. Këto në masë të madhe ndikohen nga vendi, klima, traditat dhe kultura që pasqyrohen vizuelisht në qytetet tona.

A ju pëlqen Prizreni dhe a mendoni që qyteti ju ofron kushtet e një jetese të mirë sot dhe një të ardhme të sigurtë nesër?



Në përgjithësi të rinjtë dhe fëmijët shprehen se e dojnë qytetin e tyre, por janë gjithashtu të zhgënjyer me neglizhencën që i bëhet atyre. Shumica e dijnë që kanë të drejtë mbi qytetin dhe nuk do t'u mungonin iniciativat, por nuk gjejnë përkrahjen e duhur duke u konsideruar si të vegjël!


A e konsideroni veten të gatshëm dhe të aftë që të jeni pjesë e ekipit planifikues të komunës, në mënyrë që të drejtat dhe idetë e juaja të merren parasysh?




REKOMANDIMI 4

Strategji për të drejtat e të rinjëve mbi qytetin: e cila zhvillon detajisht planin gjithëpërfshirës për të ndërtuar qytete 'miqësore' për fëmijët bazuar në konventa të njohura ndërkombëtarisht. Një strategji e tillë do të siguronte që parashikimet e bëra në letër do të shëndrohen në veprim.


Cila është mënyra më e mirë e komunikimit me Drejtorinë e Planifikimit në komunën tuaj:



Ekipi komunal i planifikimit të ju vizitoj në shkollë dhe të mbani punëtori të kohëpaskohshme me ta



Ta vizitoni Kuvendin Komunal dhe të jeni pjesë e seancave



Të pranoni propozimet/ idetë e reja/planet e ardhshme përmes emailit

Ndonëse shumica e pjesëmarrësve janë deklaruar që nuk kanë qenë ndonjëherë pjesë e iniciativave për të ndryshuar gjendjen në qytet, shumica nga ta të pyetur se a do të pranonin të ishin pjesë e ekipit planifikues janë deklaruar pozitivisht. Disa nga ta nuk kanë njohuri se kujt t'i drejtohen, disa të tjerë nuk besojnë që si të rinjë mund të ndryshojnë rrjedhat e zhvillimit në qytet, kurse problemi më i madh për të gjithë është se kërkesat e tyre refuzohen me arsyetimin që janë të vegjël.

06. Hapësirat shkollore

Unë kam të drejtë në
shkollim dhe edukim
cilësor.

Unë kam të
drejtë për çasje
në informata.




Shekulli i 21të është nën komandën e teknologjisë, inteligjencës artificiale dhe ekonomisë së dijes. Përderisa tregu kërkon aftësi specifike nga të rinjtë për të përmbushur nevojat e punës moderne në të ardhmen, politikëbërësit dhe edukatorët vazhdojnë të përdorin metoda tradicionale të mësimdhënies që si pasojë do të ketë numrin e madh të të rinjve me diplomë, por të paproflizuar për fushat përkatese të tregut aktual. Në këtë rast, rol jashtëzakonisht të rëndësishëm ka edhe infrastruktura shkollore. Është fakt i pamohueshëm që objektet shkollore me mungesë të inventarit bazë duke përfshirë kabinetet, labororet eksperimentale, teknologjinë por edhe hapësirat jashtë shkollës; nuk do të arrijnë të përmbushin nevojat e nxënësve dhe studentëve për të qenë të gatshëm për tregun e punës.

Është mëse e kuptueshme që përmirësimi i cilësisë së objekteve shkollore është i kushtueshëm. Sidoqoftë, kur ndikimi i përmirësimit të infrastrukturës shkollore do të fillojë të shfaq rezultat tek nxënësit por edhe mësimdhënësit, rezultati do të tejkalojë koston e investimeve.


Pjesë e punëtorisë me të rinjtë ka qenë edhe vlerësimi i hapësirave ekzistuese shkollore qoftë të brendshme apo të jashtme.

Vlerësimi ka përfshirë: Kualitetin e hapësirave për mësim, ndjenjën e sigurisë, mungesën e laboratoreve, kabineteve, bibliotekave, terreneve të brendshme/jashtme sportive, ndriçimin publik, mungesën e mobiluarit urban etj. Në vijim në formë diagramesh shfaqen vlerësimet e pjesëmarrësve, të cilët në punëtori, përfaqësonin shkolla dhe nivele të ndryshme të shkollimit në Prizren. Në faqet 50-51, shfaqen propozimet e tyre përkatëse.

SHKOLLA / MËSIMI / HAPËSIRA T E BRENDSHME



SHKOLLA / MËSIMI / HAPËSIRA T E BRENDSHME




Unë kam të drejtë për kujdes të mirë shëndetësor.

Unë kam nevojë për pushim dhe rekreacion. Unë kam nevojë për hapësira rekreative në lagjen, shkollën dhe qytetin tim.



Hapësira përreth shkollës | KOMFORI / QASJA / AKTIVITETI




Atraktiviteti i përgjithshëm

Ndjenja e sigurisë


Pastërtia / Kualiteti i mirëmbajtjes


Komforti i vendeve për ulje

Hapësira përreth shkollës | KOMFORI / QASJA / AKTIVITETI



Hapësira përreth shkollës | KOMFORI / QASJA / AKTIVITETI





Në dy raste gjatë anketimit të rinjtë dhe fëmijët kanë nënvizuar nevojën e menzës/hapësirës për ngrënie në shkollë. Ata shprehen që përreth shkollës së tyre (shih skemën) ka hapësira të mjaftueshme për t'u ushqyer por kjo percillet me probleme të shumta:

- 1). Cmimet janë deri diku të favorshme por cilësia e ushqimit është e dobët;
- 2). Për të siguruar ushqim ata duhet ta kalojnë në disa raste rrugën kryesore dhe rrezikohen cdo ditë nga makinat e shumta në rrugë;
- 3). Koha e pushimit të gjatë është e pamjaftueshme pasi që duhet të presin në radhë për të marrë ushqimin dhe kjo nuk ju lejon hapësirë që përtej ushqimit të kenë kohë të relaksohen në pushimin e gjatë;
- 4). Hapësirat përreth shkollës apo edhe hapësirat e tjera publike afër, sic edhe është potencuar më herët në këtë raport, shfrytëzohen nga persona që përdorin lëndë narkotike apo edhe nuk mirëmbahen çka i bënë rrefuzuese për të rinjtë.

A e përdorni transportin publik për të shkuar në shkollë?

Pjesa më e madhe e të rinjve dhe fëmijëve ecin në këmbë për në shkollë, kjo për shkak se shumica nga ta banojnë në zona afër shkollës ku frekuentojnë mësimin. Por, edhe po të kishin mundësi të shërbeheshin me transport publik, ata deklarohen se nuk do ta bënë një gjë të tillë, duke numëruar një sërë problemesh që hasin në trafik, të tilla si:

- Merr shumë kohë, nga veturat e shumta të pranishme në trafik;
- Cmimi i biletës i shtrenjtë (si për distancë 10 min, si 1 orë);
- Hapësirë e pamjaftueshme, autobusët e stërm bushur;
- Nuk kemi informata për transportin publik, nuk i dijmë oraret;
- Mungojnë stacionet dhe pikat e ndalesës, gjithashtu sinjalizimi.

Si e dalur e punëtorisë, është shqetësues fakti se sa shumë të rinjtë preokupohen për veturat, për t'iu siguruar vende parkimi atyre, madje duke u deklaruar se në raste vetura duhet të ketë përparësi para autobusit. Kjo vë re rezultat në radhë të parë i ballafaqimit të tyre të përditshëm me ngarkesat në trafik dhe së dyti mungesën e vetëdijësimit të tyre për rëndësinë e transportit publik, ecjes, bicikletës dhe formave të tjera të qëndrueshme të mobilitetit në qytet.

Me autobus Në këmbë



24%



76%

Edukimi dhe arsimimi i të rinjve do të konsiderohet i mangët përdesia shkollat nuk do të mundesojnë infrastrukturë fizike dhe sociale të denjë për zhvillim kualitativ të procesit mësimor. Edhe në diagramet e vlerësimit por edhe në diskutimin e hapur me të rinjtë pjesëmarrës, shprehen qartë problemet që shfaqen brenda shkollave në Prizren, e që në masë të madhe kanë të bëjnë me mungesë të infrastrukturës elementare nëpër shkolla, siç janë kabinetet, labororet, bibliotekat, pajisjet etj.

Të pyetur se nëse kanë në shkollën apo lagjen përreth tyre, hapësira tjera alternative ku do ta kalonin kohën e lirë dhe do të shprehnin idetë e tyre për teknologji, biznes, art etj, pothuajse të gjithë nga ta u deklaruan JO! Madje edhe anëtarët e kuvendit rinor të Prizrenit dhe ata të asamblesë së fëmijëve, shpalosën vështirësitë e shumta që kanë në gjetjen e hapësirave për t'i mbajtur aktivitetet e tyre.

Duke marrë si shembull vet objektin ku edhe mbahej punëtorja, pra kinemanë Lumbardhi, të rinjtë propozuan që shembulli i Lumbardhit-objekt në shërbim të komunitetit të ndiqet si i sukseshëm nga komuna e Prizrenit dhe të punohet tutje për të siguruar hapësira të tilla edhe për fëmijët dhe të rinjtë.

Nëse kam nevoja të veçanta, kam nevojë për kujdes të veçantë, për t'u ndjerë pjesë e shoqërisë.


Unë kam të drejtë të ndihem i sigurtë në shkollën, lagjen, qytetin tim.





REKOMANDIMI 5


Vlerësimi i ndikimit të fëmijëve: sigurimi që ka një vlerësim sistematik që vlerëson sa ligji, politikat e qytetit dhe praktika kanë ndikim në jetën e të rinjve -para, gjatë dhe pas implementimit.




Shkollat tona duhet të kenë:

Cili është ndryshimi më i madh që po të bëhej do të kishte ndikimin më të madh në shkollën tuaj?


01. Salla për lexim/Bibliotekë




02. Laboratore/Kabinete




03. Hapësirë për ngrënie/Menze



04. Mjeku/Psikologu i shkollës




05. Terrene të brendshme sportive






REKOMANDIMI 6

Buxhet i dedikuar për të rinjtë: Sigurimi i resurseve adekuate dhe rishikimi buxhetor në baza vjetore, për të dedikuar një pjesë të tij për të rinjtë e qytetit.




Qendra komunitare për të rinjë


Përtej hapësirave obligative për mësim, a keni në shkollën tuaj ose përreth në lagje hapësire (qendër rinore) ku do të kaloni kohën e lirë dhe do të shprehni idetë tuaja për teknologji, biznes, art, etj?



01. Hapësira për punë




02. Hapësira ekspozuese



03. Hapësira performuese



04. Rekreim dhe këndi i kafesë



05. Prkrahje financiare nga komuna e Prizrenit

Praktika të mira ndërkombëtare

Platforma për përfshirjen e të rinjve dhe fëmijëve në proces të planifikimit

07. Promovimi i gjithëpërfshirjes Të mësojmë nga të tjerët

Të drejtat e fëmijëve dhe të rinjve për pjesëmarrje dhe gjithëpërfshirje garantohen dhe obligohen me konventa të shumta ndërkombëtare. E drejta e tyre mbi qytetin sot është pjesë përbërëse e programeve të nismave dhe organizatave të ndryshme botërore si UNESCO, UN-Habitat, New York Academy of Urban Planning¹, etj; qëllimi i së cilave është vizionimi i qyteteve të së ardhmes tek të cilat dëgjoher zëri i të gjithëve, pa përjashtim.



REKOMANDIMI 7

Avokim i pavarur për të rinjtë: Mbështetje nga organizatat jo-qeveritare, institucionet për të drejtat e njeriut, promovimi i të drejtave të fëmijëve.



Block by block Naimbi - UN-Habitat



Block by block Mexico - UN-Habitat

Projekti Block by Block (Blok pas blloku) është bashkëpunim mes UN-Habitat - agjencisë së Kombeve të Bashkuara për zhvillim të qëndrueshëm urban - dhe krijuesit të lojërave kompjuterike Minecraft, Mojang, njëra ndër lojrat më të popullarizuara në botë. Video-loja Minecraft përdoret për të dizajnuar hapësirën publike në më shumë se 25 vende në zhvillim, përfshirë këtu edhe projektin për Prishtinën në Kosovë. E veçanta e këtij programi global është se video-loja përdoret si mjet për të angazhuar pjesëmarrjen e komunitetit në dizajnimin e hapësirave të përbashkëta publike. Target i projektit janë në veçanti grupet e ndërpërfaqësuar të komunitetit si të rinjtë, gratë dhe dhe banorët e vendbanimeve joformale.




Block by block Prishtina - UN-Habitat

Përzgjedhja e hapësirave për trajtim bëhet duke u bazuar në disa kriterë bazë që përfshijnë:
 Ndërveprimi shoqëror dhe kulturor: rritja e kohezionit të komunitetit dhe diversitetit që e karakterizon atë;
 Angazhimi dhe fuqizimi i të rinjve për të marrë pjesë në proceset e planifikimit;
 Përmirësimi i cilësisë së jetës së të gjithë banorëve urbanë, duke përfshirë impaktin pozitiv tek grupet e privuara;
 Angazhimi politik lokal: angazhimi nga komuna për të kontribuar në batimin konkret të rritjes së hapësirës publike, bazuar në idetë dhe propozimet që do të rrjedhin nga iniciativa e projektit / Minecraft dhe për të miratuar një qasje në të gjithë qytetin (parimi i njëjtë është zbatuar në projektin e Prishtinës, që për qëllim ka pasur, ridizajnimin e hapësirës së tregut në lagjen e Bregut të Diellit në Prishtinë).
 Programi në përgjithësi përbëhet nga një seri aktiviteteesh para përgaditore, duke vetëdijësuar në radhë të parë komunitetin për rëndësinë e hapësirave publike në qytet a lagje, rolin e tyre si qytetarë dhe rezultatet që priten në fund të tij.



Block by block Somalia - UN-Habitat

Y-PLAN (Youth – Plan, Learn, Act, Now) është një strategji arsimore që u mundëson të rinjve të trajtojnë problemet e botës reale në komunitetet e tyre përmes përvojave të të mësuarit bazuar nga projektet. Si një iniciativë kërkimore veprimi, Y-PLAN ka angazhuar mijëra të rinj dhe dhjetra shkolla, mësues dhe partnerë qytetarë në të gjithë Shtetet e Bashkuara dhe në mbarë botën. Aktivitetet e kësaj qendre kanë për qëllim krijimin e qyteteve të shëndetshme, qëndrueshme dhe të këndshme përmes të rinjve. Në kuadër të projektit trajtohen katër fusha kryesore që përfshijnë transportin, shërbimet dhe infrastrukturën e shkollave, banimin për të rinjë dhe hapësirat publike.



Disa nga projektet e sukseshme të qendrës janë:

1. 'Ndërtimi i Richmond-it miqësor për të rinj'-që bashkon forcat e qytetit të Richmond me të rinjtë dhe familje e tyre në çështjet klimatike? Çfarë të dhëna specifike për të rinjtë duhet të përfshihen në platformën e re të GIS dhe si mund të arrihen përfitime të tjera nga kjo?
2. 'Reduktimi i emetimeve të CO2 në qendër të qytetit'- si mund të rinjtë ta ndihmojnë 'Jack London Square' dhe 'Downtown Oakland' në zvogëlimin e sasisë së gazrave që emetohen dhe në të njëjtën kohë t'i bëjnë ato vende për një komunitet të shëndetshëm dhe të barabartë?
3. 'Bëjeni mirë: Kaloni aty ku ka ndriçim'- Si mund të angazhohen nxënësit e shkollave të mesme dhe të larta me të dhëna për të shpëtuar jetën për viktimat e trafikut dhe dëmtimet në vende të caktuara në të gjithë Nju Jorkun?
4. 'Krijimi i hapësirave të gjelbërta për nxënësit e shkollave të mesme'- Qëllimi kryesor ishte që studentëve t'u jepej jo vetëm hapësirë më e gjelbër, por edhe hapësirë për argëtim.

Qendra Y-Plan tanimë shtrinë veprimin e saj në shtatë shtete me bi 250 projekte të realizuara dhe 13 mijë të rinjë të përfshirë.

Bibliografia:

Youth Planning Program, City of Portland Bureau of Planning and Sustainability
 YOUTH ENGAGEMENT STRATEGY, Getting involved in City Planning
 Youth in Action: The Incorporation of Urban Youth in Planning-Related Practices
 Youth Engagement in Planning, Ramona Mullahey - Tools and techniques
 Active Youth Association, International EU exchange
 Ligji Nr. 04/L-174, PËR PLANIFIKIMIN HAPËSINOR
 LIGJI NR. 03/L-040 PËR VETËQEVERISJEN LOKALE
 David Harvey, THE RIGHT TO THE CITY
 MARK PURCELL, POSSIBLE WORLDS: HENRI LEFEBVRE AND THE RIGHT TO THE CITY, University of Washington
www.y-plan.berkeley.edu
www.un-habitat.org



OJQ Emancipimi Civil Ma Ndryshe (EC Ma Ndryshe)
Rr. Saraçët 5, 20000/Prizren
Bulevardi Nënë Tereza, H 30 B1 Nr. 5, 10000 Prishtinë
www.ecmandryshe.org - info@ecmandryshe.org - 038-224-967 & 029-222-771

Organizata jo-qeveritare "Emancipimi Civil Ma Ndryshe" u themelua në mars të vitit 2006. EC angazhohet për qytetari aktive në formësimin e ambientit jetësor duke nxitur organizim të mirëfilltë të komunitetit, demokratizim të institucioneve dhe pasurim të jetës kulturore në qendrat kryesore të Kosovës, me fokus në Prizren dhe Prishtinë me vizionin e krijimit të qytetit funksional që qeveriset nga të gjithë. Ndërsa vlerat të cilat e udhëheqin punën e organizatës janë: paanshmëria, aktivizmi, orientimi drejt rezultateve dhe komuniteti bazë e veprimit. EC Ma Ndryshe është ndër themelueset dhe përfaqëson Kosovën në Rrjetin e Evropës Juglindore të organizatave që merren me trashëgimi kulturore – SEE Heritage Network. Gjithashtu, është themeluese e Forumit të Trashëgimisë Kulturore të Prizrenit, Rrjetit të Organizatave Kulturore të Prizrenit dhe Rrjetit të Organizatave të Pavarura të Kulturës në Kosovë – Forumi Kulturor. EC Ma Ndryshe, që nga themelimi më 2006 është duke ushtruar presion direkt ndaj qeverisë lokale të Prizrenit për t'i krijuar qasje shoqërisë civile dhe qytetarëve për bashkë vendimmarrje. Përveç pjesëmarrjes direkte në proceset e konsultimeve publike, EC Ma Ndryshe ka avokuar rregullisht për respektimin e obligimeve ligjore për konsultime publike, përfshirjen sa më të gjerë komunitare në konsultime publike dhe përfshirjen e shqetësimeve dhe kërkesave të komunitetit në dokumentet e politikave publike.